



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY
"ISA BOLETINI"
MITROVICË**

Nr. Prot. 2046 Dt 14.09.2022

Senati i Universitetit "Isa Boletini në Mitrovicë, në përputhje me Ligjin nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë, Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, Statutin e Universitetit dhe Rregulloren nr. 1670, dt. 28.09.2021, për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini", në Mitrovicë, në mbledhjen e mbajtur më 13.09.2023, vendosi të:

**Shpall
KONKURS**

Për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime, në bazë të nevojave të njëjrive akademike të Universitetit "Isa Boletini", për vitin akademik 2022/2023

I. Fakulteti i Gjeoshkencave

1. Një mësues për lëndën: Gjuha angleze I dhe II;
2. Një asistent për lëndët: Kimi; Kimi e përgjithshme dhe Kimi inorganike;
3. Një asistent për lëndët: Grup lëndësh nga shpim-plasja-Departamenti Xehetari
4. Një asistent për lëndët: Grup lëndësh nga Gjeoinformatika; Softver Aplikativ dhe Gjeostatistika;
5. Një asistent për lëndët: Grup lëndësh në fushën Hidrogeologji me Gjeologji inxhinierike;
6. Një asistent për lëndët: Grup lëndësh në fushën Vendburimet minerale;
7. Një asistent për lëndët: Grup lëndësh në fushën e Petrologjisë – Departamenti Gjeologji

II. Fakulteti i Teknologjisë Ushqimore

1. Një mësues për lëndën: Gjuha gjermane I, II;
2. Një mësues për lëndën: Matematika I, II;
3. Një mësues për lëndën: Proceset bioteknologjike në industrinë ushqimore;
4. Një asistent për lëndët: Bazat e informatikës; Softueri aplikativ në inxhinierinë mjedisore dhe Softueri aplikativ në inxhinierinë ushqimore;
5. Një asistent për lëndën: Biologji;
6. Një asistent për lëndën: Gjuha angleze I, II;
7. Një asistent për lëndën: Gjuha gjermane I, II;
8. Një asistent për lëndët: Inxhinieria e proceseve ushqimore; Bazat e inxhinierisë së bioproceseve; Ekologjia në industrinë ushqimore; Proceset bioteknologjike në industrinë ushqimore; Kontrollimi i cilësisë së ushqimit dhe Teknologjia e mishit.
9. Një asistent për lëndët: Trajtimi i ujërave të zeza I; Monitorimi i ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore; Teknologjia e ujit dhe përpunimi i ujërave të ndotura; Trajtimi i ujërave të zeza II dhe Materiet ndotëse në produktet ushqimore;
10. Një asistent për lëndët: Monitorimi i ndotjes së mjedisit; Menaxhimi i hedhurinave; Transporti i materieve të rrezikshme; Trajtimi i ajrit të ndotur; Monitorimi dhe pastrimi i gazeve; Ndotjet industriale dhe Analiza e ndotësve të ajrit dhe ujit.

Rr. (St.)Ukshin Kovaçica, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; info@umib.net; Tel: +383-28/535725/515516 – lokali 1

III. Fakulteti i inxhinierisë mekanike dhe kompjuterike

1. Një mësimdhënës për lëndët: Metoda Jokonvencionale të Përpunimit (MP); Përpunim me Deformim (MP); Përpunim me Prerje I (MP); Përpunim me Prerje II (MP);
2. Një mësimdhënës për lëndët: Detalet e makinave I (IE); Detalet e makinave II (IE); Materialet e reparitit (IE) dhe Metodatat e matjeve inxhinierike (IE)
3. Një mësimdhënës për lëndët: Interneti & web teknologjitë (SHKI); Ark. dhe org. i kompjuterëve (SHKI) dhe Mikr. dhe mikrokompjuterët (SHKI).

IV. Fakulteti Ekonomik

1. Një mësimdhënës për lëndën: Matematika financiare;
2. Një mësimdhënës për lëndën: Shkrim Akademik;

V. Fakulteti i Edukimit

1. Një mësimdhënës për lëndët: Metodologji e mësimi të matematikës I; Metodologji e mësimi të matematikës II; Matematikë elementare I; Matematikë elementare II dhe Lojrat matematikore;
2. Një mësimdhënës për lëndët: Bazat e edukimit muzikor; Bazat e mësimi muzikor dhe Interpretim me instrumente;
3. Një mësimdhënës për lëndët: Gjuhë shqipe III; Strategji dhe metoda të shkrim/leximit dhe Metodologji e gjuhës shqipe;
4. Një asistent për lëndët: Metodologji e leximit letrar; Histori e letërsisë kombëtare; Etnologji dhe letërsi popullore; Letërsi për fëmijë;
5. Një asistent për lëndët: Metodologji e gjuhës shqipe; Gjuhë shqipe III; Strategji dhe metoda të shkrim/leximit;
6. Një asistent për lëndët: Interpretim me instrumente muzikore; Bazat e edukimit muzikor dhe bazat e arsimit muzikor;
7. Një asistent për lëndët: Edukim fizik me metodologji dhe edukim fizik në edukim parashkollor;
8. Një asistent për lëndët: TIK në arsimin fillor.

Angazhimi me honorar i bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime do të bëhet sipas propozimit të njërive akademike, në pajtim me Ligjin nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë, Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, Statutin e Universitetit dhe Rregulloren nr. 1670, dt. 28.09.2021, për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin "Isa Boletini", në Mitrovicë (tutje UIBM).

I. Procedura e angazhimit sipas konkursit dhe përjashtimet për kategori të caktuara.

Procedura e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm për ligjërata dhe ushtrime bëhet në mënyrë transparente, përmes shpalljes së konkursit publik.

II. Kushtet e angazhimit

1. Personat e angazhuar në cilësinë e bashkëpunëtorëve të jashtëm nuk marrin thirrje akademike. Angazhimi i tyre bëhet bazuar në procedurat specifike të përcaktuara me Rregulloren nr. 1670, dt. 28.09.2021, për procedurat vlerësuese lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UIBM.
2. Në UIBM nuk mund të angazhohen kandidatët të cilët kanë më shumë se një angazhim në marrëdhënie të rregullt pune, honorar apo pagesë në institucione publike apo private me pagë primare apo sekondare.
3. Në UIBM nuk do të lejohet rekrutimi/angazhimi i kandidatëve brenda ndonjëres prej strukturave themelore organizative (katedër, degë, departament apo program) nëse brenda atyre strukturave të njëjtit kanë në marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar

familjarë të ngushtë (në relacionin bashkëshortor, prind- fëmijë, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas).

III. Fondi i orëve për bashkëpunëtorët e jashtëm

1. Bashkëpunëtorët e jashtëm për ligjërata mund të mbajnë deri në 5 orë në javë.
2. Bashkëpunëtorët e jashtëm për ushtrime mund të mbajnë deri në 8 orë në javë.

IV. Kohëzgjatja e kontratës për honorar dhe kompensimi

1. Angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm bëhet për një semestër ose për dy semestra të të njëjtit vit akademik, ndërsa kontrata lidhet prej datës 1 tetor- 15 janar, ose 16 shkurt deri më 31 maj të vitit përkatës akademik.
2. Kompensimi për angazhim bëhet në bazë të orëve të realizuara, respektivisht për semestrin dimëror prej datës 1 tetor deri më datë 15 janar, ndërsa për semestrin veror prej datës 16 shkurt deri më datë 31 maj të vitit përkatës akademik.
3. Vlera e kompensimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm do të bëhet sipas rregullores për të ardhura që është në fuqi në momentin e nënshkrimit.
4. I angazhuari ka për obligim që në kuadër të kontratës të mbajë provimet për të gjitha afatet brenda vitit përkatës akademik.
5. Kandidatët të cilët do të përzgjidhen për angazhim me honorar në mësimdhënie dhe ushtrime, do të pajisen me kontrata për honorar varësisht prej fondit të orëve që posedojnë. Angazhimi sipas këtij konkursi nuk nënkupton pagesë me automatizëm gjatë periudhës për të cilën angazhohet. Nënshkrimi i kontratave për angazhim me honorar do të bëhet vetëm pas konstatimit të normës së orëve dhe grupeve që do të formohen pas pranimit të studentëve.
6. Kompensimi do të bëhet në përputhje me raportin e orëve të realizuara gjatë semestrit të caktuar i cili vërtetohet nga njësia përkatëse akademike, por jo më shumë se fondi i orëve të përcaktuara sipas rregullores në fuqi për të ardhurat personale të UIBM.
7. I angazhuari që ka thirrjen profesor në universitetet publike mund të jetë anëtar i komisionit për mbrojtjen e temave në nivelin bachelor dhe në studimet master.

V. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

1. Kandidatët që paraqiten në konkurs duhet t'i paraqesin këto dokumente:
 - a) Kërkesën për aplikim
 - b) Biografinë (CV)
 - c) Certifikatën e lindjes (jo më e vjetër se 6 muaj)
 - d) Kopjet e diplomave (bachelor, master/magjistraturë dhe doktoratë) të vërtetuara me vulë origjinale te noteri për secilën pozitë që aplikon
 - e) Kandidatët që kanë mbaruar studimet jashtë vendit, duhet të sjellin edhe dëshmi për nostrifikimin e diplomës përkatëse bachelor, master, magjistraturë, doktoratë).
 - f) Kandidatët të cilët konkurrojnë për pozitën e bashkëpunëtorit për ushtrime dhe lektorit duhet të sjellin edhe certifikatën origjinale të notave të studimeve bachelor dhe master.
 - g) Kandidatët të cilët kanë punuar në institucionet e arsimit të lartë – vendimin për zgjedhjen e fundit;
 - h) Dëshmi për punimet shkencore, monografive, teksteve mësimore, publikime në revista ndërkombëtare shkencore ose artistike, pjesëmarrje aktive në konferencat kombëtare dhe ndërkombëtare etj;
 - i) Dëshmi për përvojën e punës në mësimdhënie në ndonjë institucion të akredituar të Arsimit të Lartë;
 - j) Dëshmi nga Gjykata jo më të vjetër se 15 ditë, përmes të cilës dëshmohet që kandidati nuk është i dënuar apo nën hetime.
2. Personeli akademik si në vijim, me rastin e konkurrimit paraqesin vetëm kërkesën për angazhim:

- a. Personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune i cili në bazë të normave ligjore në fuqi ka pezulluar marrëdhënien e rregullt të punës, nëse normat ligjore brenda dhe jashtë UIBM-së lejojnë mundësinë e angazhimit të tyre në cilësinë e bashkëpunëtorëve të jashtëm.
 - b. Personeli i cili në momentin e plotësimit të moshës mandatore të pensionit ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune në UIBM dhe nëse fakulteti ka nevojë për angazhimin e tyre. Angazhimi i kësaj kategorie të bashkëpunëtorëve bëhet deri në moshën e lejuar me akte të veçanta.
 - c. Personeli akademik nga universitetet e publike të Kosovës dhe regjionit me të cilat UIBM ka marrëveshje bashkëpunimi. Personeli akademik nga kjo pikë duhet të paraqesin edhe vendimin për thirrjen e fundit akademike.
 - d. Lektorët të cilët angazhohen si rezultat i bashkëpunimit me ambasada dhe me institute e agjenci të tjera shtetërore apo marrëveshjeve me universitete të huaja.
3. Aplikacionet e pakompletuara me dokumentet e kërkuara sipas këtij vendimi nuk do të pranohen fare nga administrata e fakulteteve dhe nuk do të shqyrtohen nga komisionet vlerësuese.

VI. E drejta e ankesës

1. Fakultetet obligohen që të themelojnë komision për shqyrtimin e ankesave dhe parashtrësive lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm.
2. Komisioni i ankesave i përbërë prej 3 anëtarëve emërohet nga këshilli i fakultetit dhe në përbërjen e tij nuk mund të jenë strukturat udhëheqëse të fakultetit.
3. Kandidatet e pakënaqur kanë të drejtë ankesë pranë komisionit për ankesa në fakultetin përkatës, brenda 8 ditëve nga dita e publikimit të raportit në ueb faqen e fakultetit përkatës dhe universitetit.
4. Komisioni i ankesave më së largu 3 ditë pas përfundimit të afatit të ankesave përpilon raportin dhe propozimin përkatës e dorëzon në Këshill të Fakultetit. Këshilli i Fakultetit në afat prej 3 ditëve nga marrja e raportit duhet ta shqyrtoj propozimin dhe të vendos për miratim ose refuzim të tij.
5. Senati i Universitetit në mbledhjen e parë vendos për miratimin e propozimeve duke përfshirë edhe vendimin lidhur me ankesën të përcjella nga njësitë akademike.
6. Ndaj vendimit të Senatit nga paragrafi 5, kandidatët e pakënaqur mund të hapin konflikt administrativ në gjykatën kompetente.

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike, respektivisht nga data 15.09.2022 deri më 29.09.2022.

Dorëzimi i dokumenteve bëhet në Fakultetin përkatës prej orës 8.00-16.00.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në kopje fizike dhe elektronike në adresën elektronike: linku angazhimi2022-2023@umib.net.

Aplikacionet e arritura pas afatit dhe ato të pa kompletuara nuk do të merren në shqyrtim.

Konkursin publikohet në: www.umib.net.

